



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ARDJANA A. MEDIU
ADRESA Blv.Deshmoret e Kombit,
Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7
TEL: 692041001

KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1622

Nr. koleksioni: 494

Tirane më 30/03/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021050620037417176

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2021050620037417176



KONTRATË DHURIMI AKSIONESH

Sot, më datë 30/03 2021(dy mijë e njëzet e një), para meje Notere Ardjana A. Mediu, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tiranë, Blv."Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7, u paraqit personalisht:

- **Z. Shefqet Kastrati**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 05.06.1961, lindur në Brrut dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar prej meje me Pasaporte me Nr.SJ3343235 dhe Nr. Personal G10605213B;

Dhe

- **Z. Gani Kastrati**, shtetas shqiptar, lindur më 15.11.1952, në Brrut, Kukës dhe banues në Durrës, i identifikuar prej meje me Letërnjoftimin me Nr.031107938 dhe Nr. Personal F21115099P, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të **shoqërisë "KASTRATI GROUP" SH.A**, me nr. NUIS K21711502V;

Duke qenë se:

- **Shoqëria "CONTINENTAL GROUP" SH.A**, me nr. NUIS K01611001B, zotërohet nga Aksionarët Z. Luigj Aliaj dhe Z. Shefqet Kastrati, të cilët me anë të Vendimit të Asamblesë Nr. —, Datë 30/03/2021, kanë dhënë miratimin mbi lidhjen e kësaj kontrate dhurimi, për tjetërsimin nëpërmjet dhurimit të aksioneve që përfaqësojnë 50 % të kapitalit të shoqërisë nga z. Shefqet Kastrati, tek:
- **Shoqëria "KASTRATI GROUP" SH.A**, me nr. NUIS K21711502V, e cila me anë të Vendimit Nr. —, Datë 30/03/2021, ka dhënë miratimin mbi lidhjen e kësaj kontrate dhurimi.

NENI 1


Palët kontraktuese

1. **Z. Shefqet Kastrati**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 05.06.1961, lindur në Brrut dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar prej meje me Pasaporte me Nr.SJ3343235 dhe Nr. Personal G10605213B, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,
Nga këtu e më poshtë në kontratë referuar si **"DHURUESI"**.
2. **Shoqëria "KASTRATI GROUP" SH.A**, me nr. NUIS K21711502V, përfaqësuar nga **Z. Gani Kastrati**, shtetas shqiptar, lindur më 15.11.1952, në Brrut, Kukës dhe banues në



A2021050620037417176

Durrës, i identifikuar prej meje me Letërnjoftimin me Nr.031107938 dhe Nr. Personal F21115099P, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
Nga këtu e më poshtë në kontratë referuar si **"PRANUESI I DHURIMIT"**.



NENI 2

Objekti i kontratës

- 2.1. Objekt i kësaj kontrate është kalimi i së drejtës së pronësisë nëpërmjet dhurimit, nga Dhuruesi te Pranuesi i Dhurimit, të 3127 aksioneve që përfaqësojnë 50 % të kapitalit të shoqërisë, që Dhuruesi Shefqet Kastrati zotëron në Shoqërinë Tregtare "CONTINENTAL GROUP" SH.A me nr. NIPT K01611001B.

NENI 3

Baza Ligjore

- 3.1. Kjo kontratë hartohet bazuar në nenin 761 e vijues të Kodit Civil të R.SH dhe nenin 117 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" – i ndryshuar.

NENI 4

Vlera e dhurimit

- 4.1. Dhuruesi ia dhuron pa asnjë kundërshtim aksionet objekt të kësaj kontrate, Pranuesit të Dhurimit.
- 54.2. Pranuesi i Dhurimit, deklaron se pranon t'i dhurohen aksionet objekt të kësaj kontrate, në përputhje me parashikimet e Nenit 4 të saj.
- 4.3. Vlera totale nominale e aksioneve të dhuruara është ALL 78.175.000 (shtatëdhjetë e tetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë Lekë).

NENI 5

Të drejta dhe detyrime

- 5.1. Dhuruesi garanton Pranuesin e Dhurimit nga pretendimet e mundshme të personave të tretë mbi aksionet objekt të kësaj kontrate.
- 5.2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, pronësia mbi aksionet e specifikuar në nenin 2 të kësaj kontrate, kalon nga Dhuruesi te Pranuesi i Dhurimit.
- 5.3. Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate, Pranuesi i Dhurimit duhet të bëjë regjistrimin e saj pranë QKB-së (Qendrës Kombëtare të Biznesit).
- 5.4. Pas nënshkrimit të kontratës dhe regjistrimit të saj në QKB, Dhuruesi humbet të gjitha të drejtat e pronësisë mbi aksionet objekt të kësaj kontrate.



A2021050620037417176

NENI 6

Hyrja në fuqi

- 6.1. Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.
- 6.2. Në rast mosmarrëveshjes në lidhje me interpretimin e kontratës, palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e tyre.
- 6.3. Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

Kjo kontratë pasi iu lexua palëve dhe si u gjet konform vullnetit të tyre të lire dhe të plotë, u nënshkrua prej tyre, para meje noterës. Pas nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët, unë noterja e nënshkruaj rregullisht sipas ligjit.

PALËT KONTRAKTUESE

DHURUESI

Z. Shefqet Kastrati

PRANUESI I DHURIMIT

"KASTRATI GROUP" SH.A

Përfaqësuar nga Z. Gani Kastrati



NOTERE

Ardjana A. Mediu